



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

AD/GJTHPE/.nr.4/24

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, me Kryetarin e Gjykatës Armend Berisha, në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarit J.G, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga avokati P.P, nga K., rruga “A. R.”, nr., pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, jashtë seancës, me datë 29.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZHET ankesa disiplinore e parashtruar nga avokati P.P, nga K., ndaj gjyqtarit J.G, **SI E PABAZUAR.**

A r s y e t i m

Me datë 15.05.2024, avokati P.P, nga K., ka parashtruar ankesë disiplinore ndaj gjyqtarit J.G, për shkak të shkeljeve të rënda të detyrave të punës dhe dispozitave ligjore në fuqi të LPK-së dhe LPJ-së si dhe normave të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë, me arsyetimin se ka shkel nenin 31 të Kushtetutës, i cili garanton të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, ashtu që propozuesve për shqyrtim të trashëgimisë të lëndëve CT.nr../..., CT.nr../..., CT.nr../..., si dhe lëndës CT.nr../..., në vend që t’iu ofrohet gjykim i drejtë dhe i paanshëm me caktimin e seancave për procedim, e të cilat edhe ashtu ishin të vonuara kinse në kuptim të dispozitave ligjore të nenit 99 dhe 102 të LPK-së, u kthen lëndët në plotësim dhe korrigjim brenda afatit tre (3) ditor duke llogaritur në këtë afat pushimin dy (2) ditor për festa, kinse prokura e palëve duhet të jetë e noterizuar, obligim ky për të cilin ankuesi thekson se nuk ka dijeni ku e ka gjete gjyqtari bazën ligjore. I njëjti, ka shtuar se konsideron se me një veprim të tillë gjyqtari bie ndesh me nenin 160, 162, 163 lidhur me nenin 164 par.1 dhe par.2 të LPJ-së, ngase gjykata është e njoftuar me anë të propozimit për shqyrtim të trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e radhës së parë si dhe për gjithë masën e pasurisë të trashëgimlënësit dhe se dispozitat e mësipërme qartë përcaktojnë se që nga momenti kur gjykata e ka në dijeni faktin për një trashëgimlënës, për tërë masën trashëgimore të tij dhe për gjithë trashëgimtarët e radhës së parë, e njëjta është e obliguar me ligj që të filloj procedurën trashëgimore sipas detyrës zyrtare, duke ftuar personat që jetojnë në botën e jashtme konform nenit 116 të LPK-së lidhur me nenin 3 të LPJ-së, përmes afishimit të parashtrësive në tabelën e shpalljes si dhe në Gazetën Zyrtare, që në rastin konkret gjyqtari ka qenë i njoftuar me adresat e sakta për propozuesit që jetojnë në botën e jashtme dhe i njëjti ka qenë i njoftuar për kohën kur do të jenë në Kosovë për të dhënë deklaratat e tyre trashëgimore andaj, nga të lartcekurat rezulton se janë bërë shkelje të qëllimshme të dispozitave ligjore që përbëjnë edhe shkelje të Kodit të Etikës për Gjyqtarë. Parashtruesi i ankesës, po ashtu ka theksuar se gjyqtari J.G përmes Aktvendimit CT.nr../..., CT.nr../..., CT.nr../..., si dhe CT.nr../..., të datës 08.04.2024 dhe të datës 10.05.2024, palët i dëmton dhe i privon nga e drejta në mbrojtje dhe realizim të së drejtës subjektive, duke ju hedh poshtë propozimin për shqyrtim të trashëgimisë, me çka ka rënë ndesh me dispozitat ligjore të nenit 86.2, 89, 90, 90.3, 92.2 dhe 92.3 të LPK-së. Po ashtu, gjyqtari në fjalë vazhdon me dëmtimin e palëve dhe shkeljen e të drejtave të tyre në lëndën C.nr../..., me shqiptimin e masës së përkohshëm të sigurisë ku kërkon garancion në shumën enorme e të paparë në praktikë

gjqësore prej pesëmbëdhjetëmijë (15,000.00) euro, me çka paditësi në pamundësi për të paguar një shumë të tillë, privohet padrejtësisht nga mbrojtja e të drejtës subjektive. Gjyqtari ka vazhduar me shkeljen e të drejtave të palëve dhe dëmtimit të tyre në lëndën me propozim për zgjidhje martesës, e cila karakterizohet si lëndë e natyrës urgjente, për të cilin rast ankuesi thekson se me qëllim që të mos dëmtohet pala, e ka bart lëndën te avokati Z.M duke i thënë, citoj *“merre lëndën, se ti mund ta kryesh të gjyqtari në fjalë, ngase lëndët e mija gjyqtari në fjalë kur u vie radha për procedim, i qet prap në fund të radhës”* dhe kur avokati Z.M i'a ka përcjellë këto fjalë gjyqtarit G., gjyqtari i është përgjigje me fjalët *“ashtu është si ka thënë ai, (duke aluduar te avokati P.), por pyete atë se pse unë veprojë kështu”* mirëpo, ankuesi thekson se nuk e din pse gjyqtari vepron kështu ndaj tij. Lidhur me këtë lëndë, e cila parashtruesi i ankesës thekson se priste në sirtar për t'u proceduar, pasi i bartet avokatit Z.M me datë 24.07.2023 procedohet dhe përfundon me datë 03.08.2023, me vendim meritor për nëntë (9) ditë. Tutje, i njëjti ka theksuar se gjyqtari thellohet edhe më tej në shkelje i prirur nga epshet e ulëta hakmarrëse, kësaj radhe ndaj djalit të parashtruesit të ankesës, ku pa arsye dhe bazë ligjore me aktvendim refuzon propozimin për lejim të përmbarimit, i mbështetur në dokumentin përmbarimor - Ujdia Gjyqësore, kinse e njëjta nuk paraqet titull ekzekutiv. Duke vepruar në këtë mënyrë cenon rëndë dispozitat ligjore të nenit 2 të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë. Përfundimisht, i njëjti ka shtuar se gjyqtari J.G para vitit 2018, për seancat e këqyrjes në vend, kryesisht në lëndët e procedurës jokontestimore, ka pranuar nga palët shpërblim në shumën prej 70-100 euro, para të gatshme të konstatuar në procesverbal, pastaj në vend që të përfundohen me vendim meritor, lëndët e tilla kanë mbetur të pa përfunduara, derisa këtu parashtruesi i ankesës, në atë kohë në cilësinë e Gjyqtarit Mbikëqyrës, i përfunduar me vendim, madje edhe nëse në atë kohë ka ekzistuar bazë ligjore apo Udhëzim Administrativ i KGJK-së për një shpërblim të tillë, ankuesi thekson se nuk mund të arsyetohet lënia e lëndëve të papërfunduara me vendim, e për të cilat palëve u është marrë shpërblim. Andaj, i njëjti ka kërkuar që referuar të lartcekurave për shkak të veprimeve të tilla të kundërligjshme, të njëanshme, paragjyqëse dhe diskriminuese të iniciohet procedura disiplinore ndaj gjyqtarit J.G.

Me datë 15.05.2024, Kryetari i Gjykatës duke vepruar në kuptim të nenit 9 par.5 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës për pranimin e ankesës disiplinore të parashtruar nga avokati P.P, nga K., ndaj gjyqtarit J.G.

Me datë 15.05.2024, autoriteti kompetent duke vepruar konform nenit 6 par.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, i është drejtuar parashtruesit të ankesës me kërkesë që brenda afatit prej tetë (8) ditësh, të dorëzoj të gjitha provat e cituara në ankesë të cilat ka theksuar se po i dorëzon si provë, mirëpo të njëjtat nuk ia ka bashkëngjitur ankesës.

Me parashtresën e datës 21.05.2024, parashtruesi i ankesës avokati P.P, duke vepruar sipas kërkesës së autoritetit kompetent, ka dorëzuar aktvendimet, procesverbalet dhe parashtresat e cituara në ankesën disiplinore si dhe ka propozuar që avokati Z.M, të dëgjohej në cilësinë e dëshmitarit në seancën e Komisionit Disiplinor. Lidhur me lëndën jokontestimore për të cilat gjyqtari ka pranuar shpërblim nga pala propozuese me rastin e këqyrjes në vend, e të cilat nuk i ka përfunduar me vendim meritor, të njëjtat ka theksuar se gjenden në arkivin e gjykatës dhe mund të sigurohen konform nenit 332 të LPK-së.

Gjyqtari J.G, në deklaratën e tij të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e parashtruesit së ankesës ka deklaruar se me vëmendje ka lexuar ankesën e avokatit të parashtruar ndaj tij si gjyqtar dhe ka gjete se brenga e tij është se po i shkel të drejtat e palëve në procedurë dhe atë mu në ditën

e kushtetutës, mirëpo i njëjti me përgjegjësi të plotë ka deklaruar se gjatë këtyre viteve të shërbimit si gjyqtar që nga viti 2000, nuk ka pas asnjë ankesë verbale apo të shkruar nga palët, kurse ankesat e avokatëve që fshihen nën petkun e palëve i konsideron të shprehura në bazë të mllefrit apo inateve personale, në lidhje me vendimet që i merr e që nuk shkojnë në favorin e tyre. Lidhur me lëndët trashëgimore të cituara nga ankuesi, gjyqtari ka theksuar se pothuajse të gjitha kanë të bëjnë me të njëjtin propozues për shqyrtimin e trashëgimisë me rastin e vdekjes së gjyshit dhe prindërve të tyre, e të cilat lëndë nuk kanë qenë të kompletuara ashtu siç parashihet me dispozitat ligjore dhe ka kërkuar që të plotësohen me autorizime adekuate për avokatin. Autorizimet e dhëna nga propozuesi nuk i kanë plotësuar kushtet ligjore sepse në procedurën trashëgimore, përveç autorizimeve duhet të jetë edhe deklarata e trashëgimisë e dhënë nga propozuesit dhe të notorizuara tek noteri, e të cilat parashtruesi i ankesës për disa propozues i ka sjellë, por për shumicën e propozuesve nuk i ka sjellë, përveç disa autorizimeve të cilat nuk ka mundur t'i pranoj në procedurën trashëgimore, andaj nga këto arsye ka arritur deri te hedhja e këtyre propozimeve si të palejuara dhe të parregullta. Sa i përket lëndës me propozim për caktim të masës së përkohshme, gjyqtari ka theksuar se ka vepruar me urgjencë, ashtu siç parashihet me dispozitat ligjore, ka mbajtur seancën dëgjimore dhe sipas vlerës së kontestit ka caktuar garancionin si mjet për mbrojtjen e palës kundërshtare dhe shuma ka qenë në proporcion me vlerën e kontestit. Lidhur me lëndën ku objekt i kontestit ka qenë shkurorëzimi, gjyqtari ka theksuar se parashtruesi i ankesës në cilësinë e avokatit, nuk e ka pasur autorizimin e vërtetuar te noteri apo ndoshta pala tjetër dhe vetëm pasi që është kompletuar, është zgjidh lënda e palëve ndërgjyqëse dhe asnjë e drejtë e tyre nuk ju është shkelë. Ndërsa, sa i përket lëndës përmbarimore ku palë ka qenë djali i avokatit këtu parashtrues i ankesës, gjyqtari ka sqaruar se titulli ekzekutiv ka qenë një ujudi gjyqësore e lidhur ndërmjet palëve ndërgjyqëse në procedurë civile dhe nuk i ka përmbytur kushtet ligjore si titull përmbarimore sepse ujudia ka qenë që pala e paditur ta kthej objektin në gjendjen e mëparshme në një afat të caktuar duke mos përcaktuar shuma të hollash në emër të kompensimit të dëmit. Tutje, ka theksuar se ankuesi duke mos pasur fakte dhe prova në këto lëndë, ka filluar të trilloj gjëra të vitit 2018, e që fare nuk janë të vërteta por vetëm që të njollosin atë si individ dhe familjen e tij, andaj konsideron se deklaratat e ankuesit nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuara dhe siç po vërehet i njëjti ka edhe inate personale të vjetra. Sa i përket pretendimeve e deklarimeve tjera në ankesë, gjyqtari i kundërshton tërësisht si të pabazuara dhe aspak të argumentuara por i konsideron shpifje. Këtë ankesë e vlerëson si joprofessionale dhe të shënuar nga mllefi i pa arsyetueshëm ndaj gjyqtarit, pasi që në të gjitha lëndët ka pasur mundësi të shfrytëzoj të drejtën e ankesës, ashtu që propozon që ankesa të hedhet poshtë si e paargumentuara.

Kryetari i Gjykatës duke vlerësuar ankesën e parashtruar ndaj gjyqtarit J.G, së bashku me deklaratën e tij, ka gjetur se ankesa disiplinore është e pabazuar.

Lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës për shkelje të dispozitave ligjore në fuqi të LPK-së dhe LPJ-së, autoriteti kompetent gjen se shkelja e dispozitave ligjore, për aq kohë sa nuk përbëjnë shkelje të rënda të detyrave të punës dhe nuk janë ndërmarrë në shkelje të Kodit të Etikës, nuk hyjnë në domenin e shkeljeve të natyrës disiplinore. Andaj, në kuptim të kësaj autoriteti kompetent gjeti se pretendimet e parashtruesit të ankesës se gjyqtari ka kryer shkelje të natyrës disiplinore duke i kthyer propozimet për ndarje të trashëgimisë në plotësim dhe korrigjim në afat prej 3 ditësh, pretendimi se gjyqtari i ka dëmtuar palët dhe i ka privuar nga e drejta për mbrojtje dhe realizim të të drejtave subjektive duke ju hedh poshtë propozimin për shqyrtim të trashëgimisë, pretendimi se gjyqtari në një lëndë ka caktuar garancion në shumë enorme e të paparë në praktikën gjyqësore si dhe pretendimi se gjyqtari pa bazë ligjore ka refuzuar propozimin për lejim të përmbarimit mbështetur në dokument përmbarimor, në mungesë të provave që e dëshmojnë se i

njëjti veprimet e tilla procedurale i ka ndërmarrë në shkelje të parimeve të etikës profesionale, janë pretendime ankimore për të cilat vendos gjykata e shkallës së dytë si gjykatë me kompetencë për të vlerësuar saktësinë dhe ligjshmërinë e vendimeve të gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë, e cila gjykatë vepron bazuar në ankesën e palës së pakënaqur në procedurë.

Autoriteti kompetent vlerësoj edhe pretendimin e parashtruesit të ankesës se gjyqtari J.G ka pohuar se kur iu vie radha lëndëve të avokatit P. i qet përsëri në fund të radhës dhe ka theksuar “...pyete atë pse veproj unë kështu” dhe pretendimin se gjyqtari ka refuzuar propozimin për lejimin e përbarimit në një çështje ku palë është djalë i parashtruesit të ankesës dhe se këtë e ka bërë i prirë nga epshet e ulëta hakmarrëse dhe gjeti se këto pretendime nuk janë mbështetë dhe nuk janë argumentuar me asnjë provë, andaj pretendimet e tilla si të vetme dhe të paargumentuara nuk përbëjnë bazë të mjaftueshme për iniciimin eventual të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit.

Lidhur me pretendimin e parashtruesit të ankesës se gjyqtari G. para vitit 2018 ka pranuar nga palët shpërblim në shumë prej 70 – 100 euro për seancat e këqyrjes në vend, autoriteti kompetent ka gjetur se neni 10 i Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve përcakton se “*Autoriteti Kompetent nuk kërkon fillimin e hetimeve si dhe Këshilli nuk fillon hetimet ndaj një gjyqtari apo prokurori për shkelje disiplinore në qoftë se kanë kaluar pesë (5) vjet nga koha e kryerjes së shkeljes së supozuar disiplinore, përveç nëse shkelja disiplinore konstituon veprë penale. Në rast të tillë, do të aplikohen dispozitat e Kodit Penal në lidhje me parashkrimin.*” rrjedhimisht, shkelja e pretenduar i përket periudhës para vitit 2018 pra, para më shumë se gjashtë (6) viteve, çka nënkupton se në kuptim të shkeljes disiplinore ka arritur afati i parashkrimit. Meqë, shkelja e pretenduar përfshin elemente të veprës penale, autoriteti kompetent konform nenit 11 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve sipas së cilit “*Në rastet kur shkelja e supozuar disiplinore përmban elemente të veprës penale, Autoriteti Kompetent sipas detyrës zyrtare ia referon çështjen Prokurorit të Shtetit si dhe e njofton Këshillin, dhe Avokatin e Popullit*”, do t’i njoftoj organet kompetente për veprime të mëtejme hetimore ndaj gjyqtarit J.G si dhe parashtruesit të ankesës, avokatit P.P, i cili në periudhën që i referohet ka qenë Gjyqtar Mbikëqyrës i Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Klinë dhe sipas deklarimeve ka qenë në dijeni për veprimin e pretenduar kundërligjor të gjyqtarit të degës së tij mirëpo, nuk e ka raportuar.

Nga arsyet e theksuara me lartë, konform dispozitave ligjore te nenit 9 par.6 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, AD/GJTHPE/.nr.4/24, me datë 29.05.2024

Kryetari i Gjykatës

Armend Berisha

Vendimi i dorëzohet:

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
- 2. Gjyqtarit J.G*
- 3. Parashtruesit të ankesës – Avokatit P.P, nga K..*